



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) dhe nenin 4 paragrafi 3, nenin 60, nenin 61 dhe nenin 62 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017 miratoi:

RREGULLORE PËR LLOGARITJEN E KUFIRIT MINIMAL TË AFTËSISË PAGUESE, ADEKUATSHMËRISË SË KAPITALIT DHE FONDIT GARANTUES PËR SIGURUESIT JO-JETË

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton mënyrat e llogaritjes së kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguresit jo-jetë, si dhe afatet, format, përmbajtjen dhe mënyrën e raportimit në BQK. Po ashtu kjo rregullore përshkruan në mënyrë më të detajuar edhe elementet tjera të cilat përfshihen në llogaritjen e kapitalit, siç janë:
 - 1.1 karakteristikat e detajuara të instrumenteve të borxhit të varur si dhe,
 - 1.2 asetet jo-likuide dhe elementet tjera të zbritshëm nga kapitali.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguresit dhe degët e siguresve të jashtëm që janë të licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të ushtruar aktivitet në Kosovë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: Ligji për sigurimet) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. *Fondi Garantues* - paraqet shumën e mjeteve të kërkuara në para të gatshme, ose shumën ekuivalente me vlerën e parave të gatshme, e cila duhet të mirëmbahet gjatë tërë kohës nga siguresit dhe degët e siguresve të jashtëm të licencuar në Republikën e Kosovës sipas Ligjit të Sigurimeve, dhe është i shfrytëzueshëm vetëm në rastin kur të siguruarit rrezikohen nga pa aftësia paguese ose nga pamundësia e përmbushjes së detyrimeve financiare nga siguresit.
 - 1.2. *Llogaria e fondit garantues* - nënkupton një llogari të besuar e cila krijohet në emër të fondit garantues e cila duhet të mirëmbahet gjatë tërë kohës dhe e cila nuk mund të preket pa aprovimin e BQK-së.

- 1.3. *Aftësia Paguese* - nënkupton shumën e aseteve të siguruesit në tejkalim të çdo detyrimi apo përgjegjësie, duke zbritur prej tyre çdo aset të paprekshëm.
- 1.4. *Kapitali në dispozicion* - nënkupton shumën e kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë të përcaktuara me këtë rregullore duke përfshirë dhe çdo element të zbritshëm në llogaritjen e aftësisë paguese.
- 1.5. *Niveli i kërkuar i aftësisë paguese* - nënkupton shumën minimale të kërkuar të kapitalit në dispozicion e cila duhet të mirëmbahet gjatë tërë kohës sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
- 1.6. *Elementet e zbritshme* - nënkupton shumën e elementeve të kapitalit të cilat nuk pranohen në llogaritjen e aftësisë paguese.
- 1.7. *Shuma e primeve të sigurimit* - nënkupton shumën e primeve të shkruara bruto pa TVSH nga sigurimi i drejtpërdrejt, risigurimi dhe bashkë-sigurimi për një vit financiar duke zbritur nga kjo shumë shumën e primeve të anuluar për vitin financiar.
- 1.8. *Shuma e primeve të fituara bruto* - nënkupton shumën e primeve të fituara gjatë një viti financiar pa zbritur pjesën e risiguruesit dhe/ose bashkësiguruesit¹.
- 1.9. *Dëmet e ndodhura bruto* - nënkupton shumën e dëmeve të ndodhura gjatë një periudhe kontabël pa zbritur pjesën e risiguruesit dhe/ose bashkë-siguruesit.
- 1.10. *Dëmet e ndodhura neto* - nënkupton shumën e dëmeve të ndodhura gjatë një periudhe kontabël pas zbritjes së pjesës nga risiguruesit dhe/ose bashkë-siguruesit².

Neni 3

Kapitali i siguruesve

1. Siguruesit gjatë gjithë kohës duhet të zotërojnë kapital të mjaftueshëm në mënyrë që të mirëmbajnë aftësinë e tyre paguese.
2. Aftësia paguese përbëhet nga asetet e siguruesve të lira nga çdo detyrim/përgjegjësi e parashikueshme, duke zbritur prej tyre çdo aset të zbritshëm sipas kësaj rregulloreje.
3. Në llogaritjen e kapitalit të siguruesve duhet të merren parasysh elementet e kapitalit bazë të përcaktuara sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, kapitalit shtesë të përcaktuar sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje si dhe elementet e zbritshme nga kapitali, të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje. Kapitali i llogaritur në këtë mënyrë do të njihet si kapital në dispozicion.

Neni 4

Kapitali bazë

1. Në llogaritjen e kapitalit bazë të siguruesve përfshihen elementet e mëposhtme:

¹ Pjesa e risiguruesit dhe/ose bashkësiguruesit nënkupton – pjesën e ceduar në risigurim dhe/ose bashkë-sigurim si dhe çdo ndryshim në rezervën për primin e pafiturar që i takon risigurimit dhe/ose bashkë-sigurimit.

² Nënkupton shumën e arkëtueshme nga risiguruesi dhe/ose bashkë-siguruesit për dëme, si dhe çdo ndryshim në rezervat për dëme që ju takojnë risiguruesve dhe/ose bashkë-siguruesve.

- 1.1 Kapitali aksionar i paguar i siguruesve në para të gatshme që përbëhet mbi bazën aksioneve të zakonshme të emetuara;
 - 1.2 Rezervat e kapitalit (rezervat e njohura me ligj dhe rezervat e lira), të cilat nuk korrespondojnë me detyrimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;
 - 1.3 Fitimet e bartura nga periudhat paraprake kontabël, fitimi i periudhës së fundit kontabël i vërtetuar nga auditori i jashtëm dhe i miratuar nga Asambleja e përgjithshme e aksionareve, pas zbritjes së dividendës së pagueshme.
2. Në llogaritjen e kapitali bazë të siguruesve, elementet e mëposhtme do të konsiderohen elemente të zbritshme:
- 1.1 Aksionet e veta të riblera;
 - 1.2 Investimet në asetet e paprekshme (jo-materiale);
 - 1.3 Humbjet e bartura dhe humbjet e vitit aktual (ushtrimor);
 - 1.4 Diferenca midis rezervave për dëme të diskontuara dhe pa diskontuara (në rastet kur aplikohet dhe lejohet nga BQK).

Neni 5

Kapitali shtesë

1. Në llogaritjen e kapitalit shtesë të siguruesit përfshihen elementet e mëposhtme:
 - 1.1 Kapitali aksionar i siguruesit, i cili përbëhet nga emetimi i aksioneve preferenciale sipas shumës nominale të tyre të paguara në formën e parasë së gatshme në ekuitetin e siguruesit.
 - 1.2 Instrumentet e borxhit të varur, të përcaktuara sipas neneve 15, 16, 17 të kësaj rregulloreje.
 - 1.3 Rezervat e kapitalit që lidhen me aksionet preferenciale,
 - 1.4 Elemente tjera të kapitalit, të ndryshme nga elementet e përfshira në kapitalin bazë, por të cilat sipas natyrës janë pjesë e kapitalit të siguruesit.
2. Instrumentet e borxhit të varur janë letra me vlerë dhe instrumente të tjera financiare që autorizon titullarin në rast të falimentimit apo likuidimit të emetuesit për pagesën, vetëm pasi pretendimet e kreditorëve të tjerë të janë shlyer. Ky instrument do të pranohet në llogaritjen e kapitalit shtesë vetëm në rastin kur i plotëson kushtet e specifikuar në nenet 15, 16 dhe 17 të kësaj rregulloreje.
3. Elemente të tjera, të përmendura në pikën 1.4., të këtij neni, janë rezervat e lindura nga vlerësimi i aseteve që nuk kanë natyrë të jashtëzakonshme, si: rezerva nga vlerësimi i tokave dhe i ndërtesave, rezerva nga vlerësimi i aseteve financiare dhe rezerva nga vlerësimi i aseteve tjera.
4. Në llogaritjen e kapitalit të siguruesve, elementet e kapitalit shtesë të specifikuar sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të merren parasysh maksimum deri në 50% të shumës së kapitalit në dispozicion ose margjinës minimale të kërkuar të solvencës, të llogaritur me bazë primi dhe bazë dëmi, cilado që është më e ulët.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni, instrumentet e borxhit të varur me një periudhë fikse maturimi si dhe kapitali i paguar mbi bazën e aksioneve preferenciale me një kohëzgjatje të caktuar, do të merren parasysh vetëm deri në maksimum 25% e kapitalit bazë ose marginës minimale të kërkuar të solvencës i llogaritur me bazë prini dhe dëmi sipas kësaj rregulloreje, cilado që është më e ulët.

Neni 6

Elementet e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit

1. Në llogaritjen e kapitalit të siguresit (kapitalit në dispozicion) i cili përbëhet nga shuma e kapitalit bazë dhe kapitali shtesë do të zbriten elementet e mëposhtme:
 - 1.1. Pjesëmarrjet apo zotërimet në pronësinë e shoqërive tjera të sigurimit, risigurimit, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, firma ndërmjetësimi, shoqëri administruese si dhe institucione tjera financiare;
 - 1.2. Investimet në instrumentet e borxhit të varur dhe investimet tjera në subjektet e përmendura në pikën 1.1 të këtij neni të cilat për qëllime të pajtueshmërisë me kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit të këtyre subjekteve, do të merren parasysh në llogaritjen e kapitalit të tyre;
 - 1.3. Asetet jo likuide;
2. Asetet jo likuide të përcaktuara në paragrafin 1.3. të këtij neni janë:
 - 1.1 Aksionet e palistruara në tregjet e rregulluara;
 - 1.2 Huatë, llogaritë e arkëtueshme, dhe të gjitha transaksionet me palë të ndërlidhura, me përjashtim të transaksioneve të cilat bëhen me risigures në emër të aktivitetit të sigurimeve;
 - 1.3 Huatë nga dhe për brokerat dhe agjentët;
 - 1.4 Të arkëtueshmet nga primet dhe të arkëtueshmet nga risigurimi mbi 180 ditë;
 - 1.5 Debitorët tjerë dhe llogaritë tjera të arkëtueshme neto nga provizionimi, në vonesë mbi 365 ditë, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;
 - 1.6 Kërkesat nga debitorët, të cilët janë në proces të bankrotimit, dhe/ose kërkesat të cilat rrjedhin nga investimet e bëra në një entitet i cili është subjekt i procedurave të bankrotimit;
 - 1.7 Kërkesat apo pretendime mbi një bazë ligjore të kontestueshme;
 - 1.8 Investimet afatgjata në pronë dhe ndërtesa si dhe të drejtat në pasuri të paluajtshme të cilat nuk i plotësojnë kushtet sipas nenit 7, paragrafi 1, pika c) të Rregullores Për Investimin e Aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe Investimin e Kapitalit Themeltar, dhe të cilat janë bërë pa aprovimin paraprak të BQK-së;
 - 1.9 Investimet tjera materiale për të cilat siguresi nuk posedon dokumentacion të nevojshëm mbi pronësinë e tyre;
 - 1.10 Asetet e shtyra tatimore;
 - 1.11 Shpenzimet e parapaguara, me përjashtim të shpenzimeve të shtyra të marrjes në sigurim të përcaktuara sipas Udhëzimit të BQK-së në fuqi “mbi kalkulimin dhe regjistrimin e kostove të shtyra të blerjes në Pasqyrat Financiare”

- 1.12 50% e shumës totale të asetëve tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar;;
- 1.13 Asetet tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të konvertueshme në para të gatshme në kohën kur është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve financiare kur ato maturohen.

Neni 7

Adekuatshmëria e kapitalit, niveli i kërkuar i aftësisë paguese

1. Kapitali i siguruesve të cilët ushtrojnë aktivitet me klasat e sigurimit jojetë si dhe kapitali i siguruesve të cilët ushtrojnë aktivitet në fushën e risigurimeve nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesve.
2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesve është shuma më e lartë ndërmjet fondit garantues i përcaktuar sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje dhe 150 për qind e marginës minimale të aftësisë paguese i përcaktuar sipas këtij neni, cilado që është më e lartë ndërmjet llogaritjes me bazë primi apo dëmi.
3. Margjina e aftësisë paguese (solvencës) me bazë primi do të llogaritet si në vijim:
 - 3.1. Shuma e primeve të sigurimit që i përkasin një viti financiar deri 10 milion Euro do të shumëzohet me 0.18, ndërsa çdo shumë në tejkalim të 10 milion Euro do të shumëzohet me 0.16, ku primet e sigurimit në këtë rast do të përbëhen nga shuma e primeve të shkruara ose shuma e primeve të fituara bruto pa zbritur pjesën e risigurimit dhe/ose bashkësigurimit, cilado nga këto që është më e lartë;
 - 3.2. Shuma e produkteve të shumëzuara me faktorët përkatës sipas pikës 3.1. do të shumëzohet me raportin i cili rezulton ndërmjet:
 - 3.2.1. shumës së dëmeve të ndodhura bruto gjatë tre viteve të fundit (dëmet e paguara plus çdo ndryshim në rezervën për dëme), pas zbritjes së shumave të rikuperueshme³ nga risigurimi dhe bashkë-sigurimi si dhe,
 - 3.2.2. shumës së dëmeve të ndodhura bruto gjatë tre viteve të fundit (dëmet e paguara plus çdo ndryshim në rezervën për dëme), pa zbritur shumat e rikuperueshme nga risigurimi dhe bashkë-sigurimi.
 - 3.2.3. rezultati i fituar nga ky raport në asnjë rast nuk mund të rezultojë me pak se 0.5. Në rast se ky raport është më i vogël se 0.5, atëherë shuma e produkteve nga pika 3.2. e paragrafit 3 të këtij neni do të shumëzohet me 0.5.
 - 3.3. Në llogaritjen e shumës së primeve të sigurimit për një vit financiar, primet në lidhje me klasat sigurimeve 11, 12 dhe 13 të specifikuara sipas nenit 7 të ligjit të sigurimeve do të rriten për 50%.
 - 3.4. Në llogaritjen e shumës së primeve të sigurimit për një vit financiar, primet do të rriten edhe për shumën e primeve të pranuar nga risigurimi.
 - 3.5. Nga kjo shumë, do të zbritet shuma e përgjithshme e primeve të sigurimit, të anuluar për vitin e fundit financiar.

³ Përfshinë të gjitha shumat e arkëtueshme nga risiguruesit dhe bashkësiguruesit për dëme, përfshirë këtu çdo ndryshim të rezervave për dëme të cilat i takojnë risiguruesve dhe/ose bashkësiguruesve.

4. Margjina e aftësisë paguese (solvensës) me bazë dëmi do të llogaritet si në vijim:
 - 4.1. Mesatarja vjetore e shumave të dëmeve të paguara bruto në tre vitet e fundit financiar përfshirë këtu dhe çdo ndryshim në rezervat për dëme pa zbritur shumat për dëme që mbulohen nga risiguruesit dhe/ose bashkë-siguruesit, deri në 7 milion euro do të shumëzohet me 0.26, ndërsa shuma që tejkalon 7 milion euro do të shumëzohet me 0.23.
 - 4.2. Shumat e produkteve të shumëzuara me faktorët e sipër cekur në pikën 3.1. të paragrafit 3 të këtij neni, do të shumëzohen me raportin i cili rezulton ndërmjet;
 - 4.2.1. shumës së dëmeve të paguara bruto për tre vitet e fundit financiar (përfshirë këtu çdo ndryshim në rezervat për dëme), pas zbritjes së shumave të rikuperueshme⁴ nga risigurimet dhe bashkë-sigurimet dhe,
 - 4.2.2. shumës së dëmeve të paguara bruto (përfshirë këtu çdo ndryshim në rezervat për dëme), pa zbritur shumat e rikuperueshme nga risigurimet dhe/ose bashkë-sigurimet.
 - 4.3. Në llogaritjen e shumave vjetore të dëmeve të ndodhura bruto, shumat e dëmeve në lidhje me klasat sigurimeve 11, 12 dhe 13 të specifikuar sipas nenit 7 të ligjit të sigurimeve do të rriten për 50%;
 - 4.4. Në llogaritjen e shumës vjetore të dëmeve të ndodhura bruto, shtohet edhe shuma e dëmeve të ndodhura që i përkasin risigurimit dhe/ose bashkë-sigurimit.
5. Në llogaritjen e shumave për dëmet e ndodhura bruto të specifikuar sipas paragrafit 3, pika 3.1. e këtij neni, si referencë do të përdoret mesatarja aritmetike për tre vitet e fundit financiar.
6. Me përjashtim nga paragrafi 4 i këtij neni, në rastin kur siguruesit sigurojnë rreziqet ndaj kredive, stuhisë, breshëritë ose ngricave, si referencë në llogaritjen e shumave bruto të dëmeve të ndodhura do të merret mesatarja aritmetike për shtatë vitet financiare të fundit.
7. Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, margjina e kërkuar e aftësisë paguese për vitin e parë të aktivitetit të siguruesit do të llogaritet në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
8. Në rastin kur margjina e kërkuar e aftësisë paguese të siguruesit e llogaritur për vitin aktual financiar është më e ulët se margjina e kërkuar e aftësisë paguese e llogaritur për vitin paraprak financiar, margjina e kërkuar e aftësisë paguese për vitin ushtrimor duhet të jetë të paktën e barabartë me marginën e aftësisë paguese të vitit paraprak shumëzuar me raportin, i cili rezulton ndërmjet shumës së provizioneve për dëme pezull në fund të vitit financiar dhe shumës së provizioneve për dëme pezull në fillim të vitit financiar, por me kusht që ky raport në asnjë rast nuk duhet të jetë më i lartë se 1. Në këtë rast, në llogaritjen e këtij raporti, duhet të merren për bazë shumat e dëmeve neto nga risigurimi.

⁴ Përfshinë të gjitha shumat e arkëtueshme nga risiguruesit dhe bashkësiguruesit për dëme, përfshirë këtu çdo ndryshim të rezervave për dëme të cilat i takojnë risiguruesve dhe/ose bashkësiguruesve.

Neni 8

Fondi i Garancisë

1. Fondi i garancisë do të përbëhet nga kapitali bazë i përcaktuar sipas nenit 4 dhe kapitali shtesë sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje dhe është subjekt i miratimit nga ana e BQK-së.
2. Fondi i garancisë në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 1/3 e nivelit minimal të kërkuar të aftësisë paguese të përcaktuar sipas nenit 7 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
3. Pavarësisht nga përcaktimet në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni:
 - 3.1. Fondi i garancisë i një siguruesi të licencuar për ushtrimin e aktivitetit sigurues në Kosovë për sigurimet jo-jetë nuk mund të jetë më i ulët se 2,200,000 (dy milion e dyqind mijë) Euro;
 - 3.2. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të nenit 7 të Ligjit për sigurimet, atëherë fondi i garancisë nuk mund të jetë më i ulët se 3,200,000 (tre milion e dyqind mijë) Euro.
4. Me qëllim të garancisë së tij, shuma minimale e kërkuar e fondit garantues duhet të mbahet në njërin nga llogaritë bankare të emëruar si “llogaria e fondit garantues”, në bankat dhe/ose degët e bankave të huaja të licencuara për të vepruar në territorin e Republikës së Kosovës. Shpërndarja e mjeteve të fondit garantues do të bëhet si në vijim:
 - 4.1. 10% e fondit garantues duhet të mbahen në një llogari të BQK-së,
 - 4.2. Jo më shumë se 30% e fondit garantues në një llogari të besuar në një bankë komerciale të specifikuar sipas paragrafit 4 të këtij neni.
5. Fondi garantues mund të investohet vetëm në depozita bankare dhe në bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nuk mund të preket pa miratimin paraprak të BQK-së.
6. Çdo transaksion që ka të bëjë me fondin garantues nuk mund të bëhet pa marrë miratimin paraprak të BQK-së dhe pasi që siguruesi të ketë paraqitur kërkesën me të gjitha informacionet e nevojshme të kërkuara nga BQK-ja. Çdo transaksion kryhet vetëm përmes transferave bankare.

Neni 9

Burimi i kapitalit

1. Për të vërtetuar burimin e prejardhjes së kapitalit, siguruesi dorëzon në BQK informacionin si në vijim:
 - 1.1. Për personat juridik:
 - 1.1.1. evidencën mbi prejardhjen - burimin e krijimit të kapitalit, si raportin e auditorit të jashtëm, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të siguruesit;
 - 1.1.2. vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.
 - 1.2. Për personat fizik:

- 1.2.1. evidencën për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
 - 1.2.2. vërtetim që dëshmon përmbushjen e detyrimeve tatimore.
2. Kontributet për kapitalin e siguruesit nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare apo hua të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme dhe e panjohur.
3. Me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave, BQK-ja në bashkëpunim me Njësinë për Inteligjencë Financiare të Kosovës mund të kërkojë informacione shtesë nga aksionarët e siguruesit gjatë verifikimit të burimit të kapitalit.

Neni 10

Llogaritja dhe raportimi

1. Një sigurues duhet që në baza të rregullta tremujore dhe vjetore të llogarisë dhe të hartojë raportet lidhur me:
 - 1.1. Kapitalin;
 - 1.2. Fondin garantues;
 - 1.3. Nivelin e kërkuar të aftësisë pagueuse;
2. Siguruesit do të bëjnë llogaritjen e nivelit të kapitalit dhe fondit garantues në baza tremujore, në ditën e fundit të tremujorit kalendarit.
3. Të dhënat të cilat do të përdoren për plotësimin e raporteve tremujore lidhur me nivelin e kërkuar të aftësisë pagueuse që mbulon periudhën nga tre deri në shtatë vite, duhet të jenë në përputhje me këto rrethana:
 - 3.1. për tremujorin e parë, të dhënat nga periudha 1 Prill i vitit paraprak (përkatësisht, mesatarja aritmetike për tre ose shtatë vitet paraprake të periudhës së njëjtë kontabël) deri me 31 Mars të vitit aktual (ushtrimor);
 - 3.2. për tremujorin e dytë, të dhënat nga periudha 1 Korrik i vitit paraprak (përkatësisht, mesatarja aritmetike për tre ose shtatë vitet paraprake të periudhës së njëjtë kontabël), deri me 30 Qershor të vitit aktual (ushtrimor);
 - 3.3. për tremujorin e tretë, të dhënat nga periudha 1 Tetor i vitit paraprak (përkatësisht, mesatarja aritmetike për tre ose shtatë vitet paraprake të periudhës së njëjtë kontabël) deri me 30 Shtator të vitit aktual (ushtrimor).
4. Siguruesit duhet të dorëzojnë në BQK raportet e plotësuara sipas kërkesave në pikën 1 të këtij neni, për tremujorin e parë, dytë dhe tretë brenda një muaji pas skadimit të tremujorit raportues.
5. Siguruesit do të dorëzojnë në BQK raportet e plotësuara sipas kërkesave në pikën 1 të këtij neni, për vitin e plotë kontabël brenda një muaji pas përfundimit të vitit kalendarik.
6. Siguruesit do të dorëzojnë në BQK format e sipër cekura;
 - 6.1. Në formë elektronike;

- 6.2. Në formë të shkruar (kopje fizike), të nënshkruara nga personat përgjegjës për plotësimin e këtyre formave dhe persona tjerë përgjegjës. Format të cilat përdoren për llogaritjen e adekuatshmërisë së kapitalit duhet të jenë të nënshkruara nga aktuari i certifikuar dhe i emëruar nga siguroesi.

Neni 11

Adekuatshmëria e kapitalit për kompanitë e sigurimeve të sapo licencuara

1. Siguroesit të cilët kanë marrë licencë për të ushtruar veprimtari në sigurimet e jojetës duhet të dorëzojnë në BQK llogaritjen e vitit të parë, dytë dhe tretë të margjinës së solvencës (adekuatshmërisë së kapitalit) me bazë primi dhe dëmi, pas skadimit të vitit të parë, dytë, tretë nga fillimi i aktivitetit të tyre.
2. Siguroesit do të bëjnë llogaritjen e vitit të parë, dytë dhe tretë të margjinës së aftësisë paguese me bazë primi dhe dëmi duke u bazuar në të dhënat relative për vitin e parë, dytë dhe tretë të biznesit.
3. Me përjashtim të paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, llogaritja e margjinës së aftësisë paguese për vitin e parë të biznesit do të bëhet vetëm me bazë primi ashtu siç është specifikuar në nenin 7, paragrafi 6 të kësaj rregulloreje.
4. Në vitin e dytë dhe tretë të biznesit, siguroesit do të bëjnë llogaritjen e margjinës së aftësisë paguese në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
5. Llogaritja e margjinës së aftësisë paguese (adekuatshmërisë së kapitalit) me bazë dëmi për vitin e dytë dhe të tretë do të bazohet:
 - 5.1. Në të dhënat e vitit të parë dhe të dytë të biznesit për llogaritjen e margjinës së aftësisë paguese (adekuatshmërisë së kapitalit) për vitin e dytë;
 - 5.2. Në të dhënat e vitit të parë, dytë dhe të tretë të biznesit për llogaritjen e margjinës së aftësisë paguese (adekuatshmërisë së kapitalit) për vitin e tretë.
6. Me përjashtim nga paragrafi 5 i këtij neni, siguroesi i cili siguron rreziqe të cilat kanë të bëjnë kryesisht me rrezikun e kredisë, stuhi, breshër dhe acar duhet të llogarisin margjinën e aftësisë paguese me bazë dëmi për periudhën lëvizëse tre vjeçare, deri në skadimin e të paktën shtatë viteve nga fillimi i aktivitetit të saj. Llogaritja e parë e margjinës së aftësisë paguese me bazë dëmi për periudhën shtatë vjeçare, do të bëhet pas skadimit të paktën shtatë viteve nga fillimi i aktivitetit të siguroesit.

Neni 12

Masat e marra nga bordi i drejtorëve të siguroesve për të siguruar/arritur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese

1. Në rast se kapitali i siguroesit nuk është i mjaftueshëm, për shkak të rritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese ose shkaqeve tjera, bordi i drejtorëve i siguroesit duhet të marrë masa të nevojshme për të arritur nivelin e kërkuar të kapitalit si dhe të marrë vendime ose të propozoj lidhur me masat të cilat bien në kuadër të kompetencave të tyre ose organeve tjera përgjegjëse të kompanisë.

2. Bordi i drejtorëve të siguruesit duhet të njoftojë BQK lidhur me masat e propozuara nga paragrafi 1 i këtij neni brenda tetë ditëve kalendarike nga propozimi i tyre.
3. Përveç njoftimit të BQK-së siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, bordi drejtues i siguruesit duhet të bashkëngjit parashikimet e biznesit për pesë vitet e ardhshme financiare:
 - a) Për dy vitet e para në baza tremujore
 - b) Në baza vjetore për tre vitet tjera të mbetura
4. Projektionet e biznesit të përcaktuara sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet të përfshijnë së paku:
 - 4.1. Bilancin e gjendjes
 - 4.2. Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve
 - 4.3. Llogaritjen e adekuatshmërisë së kapitalit
 - 4.4. Llogaritjen e kapitalit në dispozicion
 - 4.5. Llogaritjen e marginës së kërkuar të aftësisë paguese
 - 4.6. Supozimet mbi bazat e të cilave janë bërë projektionet.

Neni 13

Masat e marra nga BQK

1. Në rastet kur rrezikohen interesat e të siguarve dhe/ose kapitali nuk është i mjaftueshëm ashtu siç është përcaktuar me nenin 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, BQK mund të kërkojë nga siguruesit të paraqesin planin e rimëkëmbjes së bashku me masat e propozuara për tre vitet e ardhshme financiare, i cili duhet të përmbajë:
 - 1.1. Vlerësim të shpenzimeve administrative si dhe një krahasim me shpenzimet e përgjithshme aktuale dhe komisionet;
 - 1.2. Vlerësim të hollësishëm të të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me biznesin e drejtpërdrejt të sigurimit dhe risigurimit;
 - 1.3. Parashikim të bilancit të gjendjes dhe pasqyrave tjera financiare;
 - 1.4. Llogaritjen e kapitalit dhe fondit garantues ashtu siç është përcaktuar me nenin 3 dhe 8 të kësaj rregulloreje;
 - 1.5. Llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese ashtu siç është përcaktuar me nenin 7 të kësaj rregulloreje;
 - 1.6. Vlerësim të burimeve financiare të destinuara për mbulimin e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese dhe të gjitha detyrimeve tjera të marrjes në sigurim të siguruesit;
 - 1.7. Politikat e përgjithshme dhe strategjitë e risigurimit;
2. BQK mund të detyrojë siguruesit që të mbajnë një marginë më të lartë të aftësisë paguese në rastin kur vlerësohet se të drejtat e të siguarve janë në rrezik si rezultat i pozitës së përkeqësuar financiare të siguruesit. Ky nivel më i lartë i kërkuar i aftësisë paguese duhet të bazohet në një plan të rimëkëmbjes financiare, duke përfshirë këtu një propozim për masat që do të merren në tri vitet e ardhshme.
3. BQK mund të kërkojë nga siguruesi të regjistroj rënien në vlerën e rivlerësuar të elementeve të cilat merren parasysh në përcaktimin e marginës së kërkuar të aftësisë

paguese, në rastet kur ka pasur një ndryshim të konsiderueshëm në vlerën e tregut të këtyre elementeve që nga fundi i vitit financiar.

4. BQK mund të kërkoj përshtatje/rregullim në llogaritjen e kërkuar të aftësisë paguese të siguruesit, në rastet kur vlerësohet se natyra ose cilësia e kontratave të risigurimit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në raport me vitin e fundit financiar ose kur kontratat e risigurimit nuk mundësojnë një transferim të balancuar të rreziqeve.
5. Plani i rimëkëmbjes financiare paraqitet për miratim në BQK, brenda afateve të përcaktuara nga BQK. BQK merr vendim për miratimin ose refuzimin e planit të rimëkëmbjes financiare, brenda 1 muaji nga data e pranimit të tij në BQK
6. Në rast të refuzimit të miratimit të planit të rimëkëmbjes financiare, BQK-ja merr një ose disa nga masat e tjera të mbikëqyrjes, të parashikuara me Ligjin e Sigurimeve.

Neni 14

Ndalimi i shpërndarjes së fitimeve

1. Siguruesit nuk do të lejohen të shpërndajnë fitimet në formë të dividendës apo dividendëve të ndërmjetëm ose në formë të pagesave të bazuara në pjesëmarrje në fitimet e bordit të drejtorëve, bordit mbikëqyrës apo të punësuarve tjerë në rastet kur:
 - 1.1. Kapitali i siguruesit është nën nivelin e kërkuar të aftësisë paguese i përcaktuar sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje;
 - 1.2. Si rezultat i shpërndarjes së fitimeve, kapitali i siguruesit bie nën nivelin e kërkuar të aftësisë paguese i përcaktuar sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje;
 - 1.3. Siguruesi nuk garanton nivelin minimal të likuiditetit ashtu siç është përcaktuar me nenin 64 të Ligjit për sigurimet;
 - 1.4. Siguruesi nuk ka zbatuar masat e urdhëruara nga BQK-ja për korrigjimin e në lidhje me keqinterpretimin dhe paraqitjen jo të saktë të asetëve dhe detyrimeve në pasqyra financiare ku shpalosja e vërtetë e të cilave do të ndikonte në rezultatin operativ të siguruesit.
 - 1.5. BQK-ja mund të refuzojë kërkesën për shpërndarje të dividendës, nëse sipas vlerësimit të saj, pagesa e dividendës do ta vështirësonte gjendjen financiare të Siguruesit.

Neni 15

Instrumentet e borxhit të varur si element i kapitalit shtesë

1. Siguruesit të cilët kanë për synim që të përfshijnë instrumentet e borxhit të varur si element në kapitalin shtesë, duhet të njoftojnë BQK-në së paku 30 ditë para ndërmarrjes së këtij veprimi.
2. Përveç njoftimit siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, siguruesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:
 - 2.1. Propozim-kontratën në lidhje me lëshimin e instrumentit të borxhit të varur,
 - 2.2. Parashikimet e biznesit për pesë vitet e ardhshme.

3. Parashikimet e biznesit nga paragrafi 2 i këtij neni duhet që së paku të përfshijnë kushtet e përcaktuara në nenin 11 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje dhe të dorëzohen në BQK në përputhje me nenin 10 paragrafi 6 të kësaj rregulloreje.
4. Siguruesit mund të paraqesin instrumentet e borxhit të varur si element të kapitalit në llogaritjen e kapitalit shtesë nëse janë plotësuar kushtet e mëposhtme:
 - 4.1. Në qoftë se kontrata në mes të siguruesit si emetuesi dhe zotëruesit të instrumenteve të borxhit të varur në mënyrë të qartë tregon se në rast të falimentimit apo likuidimit të emetuesit/siguruesit, mbajtësi ka të drejtën e pagesës vetëm pasi pretendimet e kreditorëve të tjerë të janë shlyer/paguar,
 - 4.2. Nëse kapitali është paguar plotësisht, d.m.th. vetëm shuma e paguar e kapitalit është marrë në konsideratë,
 - 4.3. Kontrata ndërmjet siguruesit dhe kreditorit të varur nuk duhet të përmbajë dispozita të cilat do të lejonin kreditorit të marrë pagesën para datës së specifikuar të maturimit, përveç në rast të falimentimit apo likuidimit të siguruesit, ose nëse ajo është paraparë ndryshe me këtë Rregullore,
 - 4.4. Kontrata ndërmjet siguruesit dhe kreditorit të varur mund të ndryshohet vetëm nëse BQK ka dhënë miratimin paraprak.
5. Siguruesit mund ta paraqesin kapitalin e borxhit të varur si element në llogaritjen e kapitalit shtesë që përmban një datë të specifikuar maturimi si dhe kapitalin e borxhit të varur pa një datë të specifikuar maturimi.
6. Në qoftë se siguruesi ndalon në përmbushjen e kërkesave të specifikuara në paragrafin 4 të këtij neni atëherë kapitali i borxhit të varur nuk do të pranohet në llogaritjen e kapitalit shtesë.

Neni 16

Kapitali i borxhit të varur me një datë të specifikuar maturimi

1. Përveç kushteve të përmendura në nenin 15 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, kapitali i borxhit të varur që përmban një datë të specifikuar maturimi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - 1.1. Maturimi i specifikuar duhet të jetë të paktën 5 vite e 1 ditë,
 - 1.2. Në llogaritjen e kapitalit shtesë, siguruesi duhet në mënyrë graduale të zvogëlojë kapitalin e borxhit të varur me një zbritje kumulative prej 20% për 5 vitet e fundit para datës së maturimit, si më poshtë:
 - 1.2.1. kur llogaritet kapitali shtesë për pesë vite ose më pak se pesë vite dhe më shumë se katër vite para datës së shlyerjes së plotë ose të një pjese të shumës së instrumentit financiar të borxhit të paguar, një zbritje prej 20% do të përdoret për atë pjesë të shumës,
 - 1.2.2. kur llogaritet kapitali shtesë më pak se katër vjet dhe më shumë se tre vjet para datës së shlyerjes, do të përdoret një zbritje prej 40%,
 - 1.2.3. kur llogaritet kapitali shtesë më pak se tre vjet dhe më shumë se dy vjet para datës së shlyerjes, do të përdoret një zbritje prej 60%,

- 1.2.4. kur llogaritet kapitali shtesë më pak se dy vjet dhe më shumë se një vit para datës së shlyerjes, do të përdoret një zbritje prej 80%,
- 1.2.5. kur llogaritet kapitali shtesë një vit apo më pak se një vit para datës së shlyerjes, do të përdoret një zbritje prej 100%, dhe kjo shumë e kapitalit të borxhit të varur nuk do të përfshihet në llogaritjen e kapitalit shtesë.

Neni 17

Kapitali i borxhit të varur pa ndonjë datë të specifikuar maturimi

1. Përveç kushteve të përmendura në nenin 15 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, kapitali i borxhit të varur që nuk përmban ndonjë datë të specifikuar maturimi duhet të plotësoj kushtet e mëposhtme:
 - 1.1. Instrumenti financiar nuk mund të paguhet me iniciativën e zotëruesit pa marrë miratimin paraprak nga BQK, përveç në rastin siç është specifikuar në paragrafin 2.1. të këtij neni;
 - 1.2. Siguruesi duhet të siguroj një mundësi për të shtyrë pagesën e kthimit të këtij instrumenti financiar.
2. Kapitali i borxhit të varur mund të paguhet në këto raste:
 - 2.1. Nëse një njoftim paraprak i është dorëzuar BQK-së pesë vite para datës së shlyerjes së planifikuar të kapitalit të borxhit të varur, në mënyrë që të mundësohet llogaritja e zbritjes së këtij kapitali/instrumenti siç është specifikuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje në llogaritjen e kapitali shtesë;
 - 2.2. Nëse kapitali i borxhit të varur nuk është pjesë përbërëse e kapitalit shtesë, d.m.th. nëse ajo është llogaritur me një zbritje 100%;
 - 2.3. Nëse një miratim paraprak për shlyerje më të hershme është marrë nga BQK.
3. Në rast se siguruesit kanë për qëllim shlyerjen e parakohshme, duhet që paraprakisht të njoftojnë BQK-në të paktën gjashtë muaj para datës së shlyerjes si dhe të ofrojnë një plan lidhur me llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit para dhe pas datës së shlyerjes. BQK do të autorizojë ripagesën apo shlyerjen vetëm në qoftë se ky plan tregon se kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit të specifikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje do të përmbushen edhe pas shlyerjes apo ripagesës së këtij instrumenti.

Neni 18

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave administrative dhe dënimeve me gjobë siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore dhe Ligjin 05/L-045 për Sigurimet.

Neni 19

Dispozitat kalimtare

Siguruesit ekzistues duhet të jenë në pajtim me kërkesat e kësaj rregulloreje deri me datën 01 mars 2017.

Neni 20
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha dispozitat e Rregullores mbi Depozitimin e Aseteve si Garancë, Mjaftueshmërisë së Kapitalit, Raportimin Financiar, Menaxhimin e Riskut, Investimeve dhe Likuiditetin, që kanë të bëjnë me adekuatshmërinë e kapitalit dhe solvencës, e miratuar nga Bordi i BQK-së më 30 prill 2015.

Neni 21
Shtojcat

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore janë edhe dy format e bashkangjitura: Shtojca I - Tabela për llogaritjen e aftësisë paguese (solvencës) dhe Shtojca II – Tabela për llogaritjen e kapitalit.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 mars 2017.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Prof. Dr. Bedri Peci

Shtojca I

1. Tabela për llogaritjen e aftësisë paguese (Solvenca)

1	Tabela e Rezervave për dëme	Paraprake 3	Paraprake 2	Paraprake 1	Aktuale
1.1	Kërkesat për dëme pezull në fillim të periudhës				
1.2	Demet e Paguara				
1.3	Kërkesat për dëme pezull në fund të periudhës				
1.4	Humbjet e ndodhura (1.2 + 1.3) - 1.1	-	-	-	-
1.5	Mesatarja e humbjeve të ndodhura		-		-
2	Tabela e pjesës së kërkesave nga Risiguruesi				
2.1	Pjesa e Risigurimit për dëmet pezull në fillim të periudhës				
2.2	Risigurimi I pranuar				
2.3	Pjesa e Risigurimit për dëmet pezull në fund të periudhës				
2.4	Pjesa e Risigurimit për humbjet e ndodhura	-	-	-	-
2.5	Neto humbjet e ndodhura (demet e mbajtura)	-	-	-	-
2.6	Niveli i mbajtjes				
2.7	Mesatarja e nivelit të mbajtjes				
3	Në bazë të primeve			Paraprake 1	Aktuale
3.1	Bruto primit e shkruara				
3.2	Ndryshimi I primeve				
3.3	Për Kl: 11, 12, 13 rritje e primit për 50%				
3.4	Tjera (Tax & risigurimi)				
3.5	Gjithsej			-	-
3.6	Shtresa e parë (fikse deri në 10 milionë)			10,000,000	10,000,000
3.7	Shtresa e dytë (mbi 10 milionë)			-	-
3.8	Përqindja e shtresës së parë (fikse)			18%	18%
3.9	Përqindja e shtresës së dytë (fikse)			16%	16%
3.10	Rezultati në bazë të primeve			-	-
3.11	Niveli i mbajtjes			#DIV/0!	#DIV/0!
3.12	Rezultati i aftësisë paguese në bazë të primeve			-	-
4	Në bazë të dëmeve				
4.1	Bruto demet e ndodhura (shih tabelën e dëmeve)			-	-
4.2	Shtresa e parë (fikse)			7,000,000	7,000,000
4.3	Shtresa e dyte				
4.4	Përqindja e shtresës së parë (fikse)			26%	26%
4.5	Përqindja e shtresës së dytë (fikse)			23%	23%
4.6	shume e shtresës së parë			0	0
4.7	Raporti midis Neto dhe Bruto dëmeve të ndodhura			#DIV/0!	#DIV/0!
4.8	Perqindja minimale			50%	50%
5	Rezultati i aftësisë paguese në bazë të dëmeve			-	-
5	Aftësia Paguese e kërkuar (Solvenca)				
5.1	Bazë primeve			-	-
5.2	Bazë dëmeve			-	-
5.3	Aftësia Paguese e kërkuar			-	-
5.4	Aftësia Paguese e kërkuar për vitin paraprak			-	-
5.5	Aftësia paguese mbi bazën e rritjes prej 150%			-	-

Shotja II

2. Tabela për llogaritjen e kapitalit

	Paraprake 1	Aktuale
I KAPITALI BAZE, Neni 4: (1 + 2 + 3)	-	-
1 Kapitali aksionar i paguar i siguruesve në para të gatshme	-	-
2 Rezervat e kapitalit (rezervat e njohura me ligj dhe rezervat e lira),	-	-
3 Fitimet e akumuluar të mbartura pas zbritjes së dividendëve për t'u paguar	-	-
II ELEMENTET E ZBRITSHME NGA KAPITALI BAZË, Neni 4: (1 + 2 + 3 + 4)	-	-
1 Aksionet e veta të riblera	-	-
2 Investimet në asetet e paprekshme (jo-materiale);	-	-
3 Humbjet e bartura dhe humbjet e vitit aktual (ushtrimor);	-	-
4 Diferenca midis rezervave për dëme të diskontuara dhe pa diskontuara	-	-
III KAPITALI SHITESH, Neni 5; (1 + 2 + 3 + 4), max 50%	-	-
Kapitali aksionar i siguruesit, i cili përbëhet nga emetimi i aksioneve preferenciale sipas shumës	-	-
1 nominale të tyre të paguara në formën e parasë së gatshme në ekuitetin e siguruesit	-	-
2 Instrumentet e borxhit të varur,	-	-
3 Rezervat e kapitalit që lidhen me aksionet preferenciale	-	-
4 Elementet tjera	-	-
IV KAPITALI RREGULLATOR, (I - II + III)	-	-
ELEMENTET E ZBRITSHME NË LLOGARITJEN E KAPITALIT, Neni 6: (1 + 2)	-	-
V	-	-
1 Pjesëmarrjet apo zotërimet në pronësitë e shoqërive tjera	-	-
2 Investimet në instrumentet e borxhit të varur	-	-
VI Asetet jo likuide, Neni 6; (1 deri 9)	-	-
1 primet e arkëtueshme dhe debitorët nga risigurimi mbi 90 ditë	-	-
2 huatë dhe llogaritë e arkëtueshme me palë të ndërlidhura	-	-
3 debitorët dhe llogaritë tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin nga veprimtaria e sigurimit	-	-
4 huatë nga brokerat dhe agentët	-	-
5 100% të shpenzimeve të parapaguara dhe aseteve të shtyra tatimore	-	-
6 asetet tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim	-	-
7 asetet tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të konvertueshme në para të gatshme	-	-
8 Asetet e paprekshme (intagable Aset)	-	-
9 tjera	-	-
VII Pasuria Neto - Kapitali në dispozicion (IV - V - VI)	-	-
VIII Fondi garantues sipas ligjit	3,200,000	3,200,000
IX Kërkesa për kapital sipas Fondit Garantues	(3,200,000)	(3,200,000)
X Kërkesa për mbulueshmëri të solvences	-	-
XI Kërkesa përfundimtare për shtim të kapitalit	3,200,000	3,200,000